



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pzd.nr.105/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Xh. (Sh.) S., nga fshati D., komuna e H. të E., për shkak të veprës penale krimi i organizuar nga neni 283 par.2 lidhur me nenin 273 par.2 si dhe lidhur me nenin 281 par.1, nënpar.1.9 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e të dënuarit për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.10.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të dënuarit Xh. S. për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.39/2019 të datës 26.02.2021.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.39/2019 e datës 26.02.2021, të dënuarin Xh. S. për shkak të veprës penale krimi i organizuar nga neni 283 par.2 e lidhur me nenin 273 par.2 si dhe lidhur me nenin 281 par.1, nënpar.1.9 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 09.02.2019 e tutje, dhe dënim me gjobë në shumë prej 3500 (tremijepesëqind) €, të cilat dënime do të ekzekutohen 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.23/2021 e datës 21.09.2021, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit Xh. S., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur i të dënuari Xh. S., me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi kërkesën si të bazuar, dhe t'ia zbusë lartësinë e dënimit ti shqiptojë një dënim më të butë në mënyrë që sa më shpejt të jetë pran familjes.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me parashtresën KZJD.nr.105/2024 e datës 30.09.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me shkresën KP.nr.313/2024, e datës 13.09.2024 si dhe Prokurori Speciale, në përgjigjen PPS.nr.54/2019 e datës 11.09.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, propozimet e lartë cekura dhe gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashihet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, paraqiten rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënimin më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikonin në një dënim më të butë, gjithnjë duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Në kërkesën e të dënuarit theksohet se e ka gjendjen e dobët ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, e ku gjatë vuajtjes së dënimit babai i tij ka ndërruar jetë, se nëna e tij është me diagnozë të kancerit, dhe është e vetme në shtëpi dhe nuk ka kush të përkujdeset për të, pasi që vëllau është invalid i luftës dhe jeton jashtë shtetit, ku për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike nuk ka mundur ta paguaji dhe është detyruar që ta vuaj me burgim. Kërkesë ia ka bashkangjitur raportin e komisionit profesional për komisionin invalidor të lëshuar nga QKUK-Klinika e Onkologjisë të datës 10.03.2024.

Nga shkresat e lëndës del se gjykatat e instancave më të ulëta me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit kanë vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit. Rrethanat në të cilat thirret mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë e të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit por që konsiderohen si rrethana të reja, nuk e kanë intensitetin e tillë që të ndikojnë në zbutjen e dënimit, e as që mund të karakterizohen si rrethana që e arsyetojnë shqiptimin e një dënimi më të butë. Ndërsa nga raporti i komisionit profesional në emër të nënës të dënuarit del se asaj i është rekomanduar për komision invalidor.

Nga sa u tha më lartë, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.7 të KPP-së, vendosi si në dispozitivë të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pzd.nr.105/2024, më datë 09.10.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi